



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E LARTË
KOLEGJI PENAL**

**Nr. 61004-00391-2021 i Regj. Themeltar
Nr. 00-2021- 356 i Vendimit**

VENDIM

NË EMËR TË REPUBLIKËS

Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë i përbërë nga gjyqtarët:

**Illir PANDA
Albana BOKSI
Klodian KURUSHI**

**Kryesues
Anëtare
Anëtar**

Sot, në datë 01.06.2021, mori në shqyrtim, në dhomë këshillimi, çështjen penale që i përket:

- KËRKUES:** Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës,
- PERSONI NËN HETIM:** Selim Çekaj
- I DYSHUAR:** Për veprën penale të “Trafikimi i narkotikëve” e kryer në bashkëpunim të parashikuar nga neni 283/a-2 i Kodit Penal.
- OBJEKTI:** Vleftësim i ligjshëm i arrestit në flagrancë dhe caktim mase sigurimi “arrest në burg”.
- BAZA LIGJORE:** Nenet 229, 230/3,232 gërma “dh”, 238 dhe 259/3 të Kodit të Procedurës Penale.

KOLEGJI PENAL I GJYKATËS SË LARTË

Pasi dëgjoji relatimin e gjyqtarës Albana Boksi dhe shqyrtoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N :

I. Rrethanat e çështjes

1. Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, ka paraqitur kërkesë për vleftësim arresti në flagrancë dhe caktim mase sigurimi, për personin nën hetim Selim Çeka i dyshuar për veprën penale “Trafikimi i narkotikëve”, kryer në bashkëpunim të parashikuar nga neni 283/a-2 i Kodit Penal.

2. Nga aktet e përfshira në fashikull, rezulton se në datë 31.03.2021, rreth orës 12:40, Dega e Doganës Durrës ka njoftuar Policinë Gjyqësore Durrës se, në Portin Detar Durrës ndodhej kontenieri me numër shasie MMAU-1282264, i kompanisë “MAERSK” dhe me kompani shitëse “Fresh Fruits Finest”, me të cilin po eksportohehin mallra nga shteti i Ekuadorit për llogari të subjektit shqiptar “ECOALMAX” sh.p.k, me adrese në Maminas, Durrës dhe administrator personin nën hetim Selim Çekaj. Kontenieri i mësipërm ishte i ngarkuar me banane, ndërkohë që kontrolli i tij është kryer në praninë e administratorit Selim Çekaj, duke ukontrolluar pikërisht në vendin ku ndodhej dhe markimi me shenjë të kuqe, pas skanimit.

3. Gjatë kontrollit fizik, në pjesën e dyshemesë nga pjesa e jashtme dhe në traversat e poshtme të shasisë, është konstatuar prania e një lende me ngjyre të bardhë në formë pluhuri, me karakteristikat e lëndës narkotike të llojit kokainë. Në vijim të veprime hetimore, është bërë sekuestrimi i sasisë së lëndës narkotike të gjetur në masën e 48 kg dhe 754 gram, e ndarë në 40 pako dhe në këto kushte, është kryer arrestimi në flagrancë i shtetasit Selim Çekaj, me cilësinë e administratorit të shoqërisë pritëse të kontenierit, ku dhe u gjet droga, si i dyshuar për kryerjen e veprës penale të “Trafikimit të narkotikeve”, e kryer në bashkëpunim të parashikuar nga neni 283/a-2 të Kodit Penal.

4. **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës** me vendimin nr. (11-2021-2049)131/4, datë 02.04.2021, ka vendosur:

- *Vlerësimin të ligjshëm të arrestimit në flagrancë të datës 01.04.2021, ora 14:00 të shtetasit Selim Musa Çekaj, i dyshuar për kryerjen e veprës penale të “Trafikimit të narkotikeve”, parashikuar nga neni 283/a/2 i Kodit Penal, në zbatim të nenit 259, pika 3 të KPP.*

- *Të caktojë si masë sigurimi personal “arrest në burg” për shtetasin Selim Musa Çekaj, në zbatim të neneve 232 gërma “dh” e 238 të K.Pr.Penale.*

- *Një kopje e këtij vendimi i dërgohet Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Durrës për zbatim.*

- *Kundër vendimit mund të bëhet ankim brenda 5 ditëve në Gjykatën e Apelit Durrës, nga e nesërmja e shpalljes.*

4.1. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës në arsyetimin e saj, ndër të tjera ka theksuar se: “... Gjykata vlerëson se nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Durrës po kryhen hetime për një veprë me rrezikshmëri të madhe shoqërore atë të “Trafikimit të narkotikëve”e kryer në bashkëpunim dhe këto hetime janë përqendruar për evidentimin e këtij aktiviteti kriminal e të paligjshëm ku duhet të jenë përfshirë elementë me aktivitet kriminal në fushën e trafikimit të lëndëve narkotike, për një veprë penale që parashikon dënim nga 10 deri në 20 vjet burgim. Në këtë aktivitet kriminal ka dyshime të arsyeshme se është përfshirë edhe personi nën hetim. Gjykata konkludon se në rastin konkret ka shkaqe të një rëndësie të veçantë për evidentimin e të gjithë aktivitetit kriminal e të paligjshëm të kryer në fushën e trafikimit të narkotikëve dhe të personave të përfshirë në këtë aktivitet të paligjshëm që përcakton pika 3 e nenit 230 të K.P.Penale e për shkaqet e më sipërme ndaj personit duhet caktuar masa shtrënguese “arrest në burg”.

4.2. Ndaj vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, ka paraqitur ankim personi në hetim Selim Çekaj, ku ka kërkuar “Prishjen e vendimit (11-2021-2049)131/4, datë 02.04.2021, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës dhe rrëzimin e kërkesave të prokurorisë duke urdhëruar lirim të Selim Çekaj nga paraburgimi”.

5. **Gjykata e Apelit Durrës** me vendimin nr.10-2021-778(107), datë 22.04.2021, ka vendosur:

“Miratimin e vendimit me Nr.131/4 (11-2021-2049), date 02.04.2021 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës.

Kundër këtij vendimi mund të bëhet rekurs në Gjykatën e Lartë sipas ligjit.”

5.1. Gjykata e Apelit Durrës në arsyetimin e saj ndër të tjera ka shpjeguar:

- *Ndryshe nga sa pretendohet në ankim, në lidhje me shtetasin Selim Çekaj për faktin penal objekt procedimi penal, me aktet hetimore të verifikuara deri në këtë fazë dhe me njoftimet që japin provat e deritanishme, ka rezultuar i drejtë dhe i ligjshëm arrestimi i tij në flagrancë. Kjo pasi në kushtet që malli i mbërritur në Portin Detar Durrës, nëpërmjet kontenierit ku është gjetur lënda narkotike, i përkiste pikërisht*

kompanisë së drejtuar nga shtetasi Selim Çekaj dhe do të shkonte për këtë kompani, dyshimi i parë mbi destinacionin e këtij malli bashkë me përkatësinë e lëndës narkotike të gjetur në të, lidhet pikërisht me këtë shtetas, përse kohë që nuk ka të dhëna provuese që të përjashtojnë lidhjen e personit nën hetim me lëndën narkotike. Është e vërtetë fakti i pretenduar se, personi nën hetim nuk ka qenë i pranishëm në Ekuador në kohën e ngarkimit të kontenierit, por një fakt i tillë nuk mund të përjashtojë apriori dyshimet fillestare në ngarkim të tij, përse kohë që ka qenë ai personi pritës i mallit. Në këtë linjë arsyetimi, vlerësohet se është pjesë e hetimit të mëtejshëm për identifikimin e personave të tjerë autorë të veprës penale, si dhe masën e përfshirjes së personit nën hetim në kryerjen e krimit.

- Arrestimi në flagrancë, është i bazuar në ligj, pasi ekzistojnë të dhëna mbi dyshimin e arsyeshem bazuar në prova në drejtim të të arrestuarit, pasi ai ka qenë dhe mbetet deri aktualisht i vetmi pritës i mallit në kontenier, ku dhe është gjetur lënda narkotike.

- Gjykata e Apelit në lidhje me këtë pretendim vlerëson se, në caktimin e masës së sigurimit personal “arrest në burg” nga gjykata e shkallës së parë është mbajtur parasysh përshtatshmëria e kësaj mase me shkallën e nevojave të sigurimit që duhen marrë në rastin konkret, pavarësisht përcaktimeve të nenit 230 të K.P.Penale dhe fakteve të provuara mbi moshën e personit nën hetim pasi, në këtë rast është vlerësuar me të drejtë se jemi në kushtet përjashtimore të nenit 230 të K.P.Penale, sepse rrezikshmëria e veprës penale, vetë faktit penal të konstatuar është shumë e lartë. Në këtë rast jemi para një veprë penale me marzhe dënimi me burgim tejet të lartë, si dhe vetë rrethanat e ndodhjes së faktit penal, janë të tilla që rrisin së tepërmi rrezikshmërinë e veprës penale, sepse jemi para trafikimit të një sasive të madhe lënde narkotike e llojit kokaine, nëpërmjet rrugëtimit dhe mënyrës së kryerjes që paraqet mjaft rrezikshmëri për tërësinë e marrëdhënieve juridike që synon të mbroj ligji penal.

- Sa i takon rrezikut të ikjes referuar personalitetit të personit nën hetim, moshës së tij dhe gjendjes shëndetësore, nuk vërehet ndonjë rrezik real ikje, por një fakt i tillë mbetet i pamjaftueshëm për zbutjen e masës së sigurimit, përse kohë çështja është në fazën e parë të hetimit dhe ka nevojë për marrjen e provave që do të mund të zbardhin situatën dhe shkallën e përfshirjes së të arrestuarit në këtë krim të konstatuar.

6. Kundër vendimit me nr. 10-2021-778(107), datë 22.04.2021, të Gjykatës së Apelit Durrës, ka paraqitur rekurs më datë 28.04.2021, personin në hetim Selim Çekaj me të cilin ka kërkuar: “Prishjen e vendimit me nr.10-2021-778(107), datë 22.04.2021 të Gjykatës së Apelit Durrës dhe caktimin e një mase sigurimi më të butë për të arrestuarin Selim Çekaj dhe lirim nga paraburgimi”. Në rekurs janë parashtruar këto shkaqe:

- Arrestimi i shtetasit Selim Çekaj është kryer në kundërshtim me kriteret ligjore mbi gjendjen e flagrancës, pasi ky shtetas nuk ka qenë në posedim të lëndës narkotike të sekuestruar në kontenier. Në momentin e kryerjes së arrestit, ka munguar gjendja e flagrancës parashikuar në nenin 252 i K.P.Penale. I arrestuari ka qenë në shtëpi në kohën kur është njoftuar të paraqitet në ambientet e Portit Durrës, ku do të ushtrohej kontroll në kontenierin me banane, të mbërritur për llogari të subjektit tregtar që ai ka në administrim. I arrestuari nuk ka qenë në posedim direkt të kontenierit, i cili është ngarkuar me banane në Ekuador pa praninë e tij dhe ka kryer një udhëtim të gjatë për të mbërritur deri në Durrës. Në këtë rast mungon gjendja e flagrancës pasi, lënda nuk i është kapur Selim Cekes, por është kapur në kontenier akoma të pa marr në dorëzim dhe në këto rrethana arrestimi i kryer në flagrance duhet të deklarohet i paligjshëm, pasi ky shtetas nuk është kapur në kryerje e sipër të veprës penale apo menjëherë pas kryerjes, sikurse dhe prova materiale nuk i është kapur atij.

- Masa e sigurimit “arrest në burg” ndaj shtetasit Selim Çekaj është caktuar në kundërshtim me kushtet dhe kriteret ligjore të përcaktuara në nenet 228, 229 dhe 230 të K.P.Penale, në mungesë të dyshimit të arsyeshem bazuar në prova, si kusht kryesor pa të cilin ndaj askujt nuk mund të caktohet një masë sigurimi. Nuk ka asnjë të dhënë provuese se shtetasi Selim Çekaj të ketë lidhje apo kontakte direkte në Ekuador ku dhe është nisur ngarkesa, ai ka qenë thjesht pritësi i mallit të porositur sipas kontratës, banane. Qëndrimet e gjykatave janë në kundërshtim me Vendimin Unifikues të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lart me nr. 7 të vitit 2011.

- Nuk janë respektuar kriteret për caktimin e masës së sigurimit, të parashikuara në nenin 229 të K.P.Penale, si dhe kushtet e veçanta për masën ekstreme arrest në burg, përcaktuar në

nenin 230/1 të këtij Kodi, pasi shtetasi Selim Çekaj është me moshe 72 vjeç dhe ligji procedural penal e ndalon caktimin e masës së sigurimit arrest në burg në këto raste, me përjashtim kur i pandehuri paraqet rrezikshmëri të lartë shoqërore apo dhe vetë vepra penale paraqet rrezikshmëri të theksuar shoqërore. Neni 230 është krijuar nga ligjvënësi si një dispozitë mbrojtëse për personat me të dhëna specifike që hyjnë në kategorinë e pacaktuar nga ligja. I dyshuari ka një sërë rrethanash lehtësuese siç është fakti që ai është i sëmurë, jeton me bashkëshorten 73 vjeçare e cila edhe ajo është e sëmurë dhe që të dy kanë nevojë për përkujdesjen e mjekut.

II. Vlerësimi i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë

7- Rekursi, nga personin në hetim Selim Çekaj është paraqitur brenda afatit 45 ditor të parashikuar në nenin 435 të Kodit të Procedurës Penale. Prokuroria pranë Gjykatës së Apelit Durrës është njoftuar për rekursin nëpërmjet dëftesës së komunikimit.

8- Në lidhje me masat e sigurimit, e drejta për të ushtruar rekurs kundër vendimit të gjykatës së apelit, është parashikuar shprehimisht në nenin 249 pika 8 të KPP, ku theksohet se ‘rekursi në Gjykatën e Lartë lejohet për shkelje të ligjit, brenda kompetencës së saj’. Në këtë vështrim, rekursi në lëndë të masave të sigurimit duhet të evidentojë shprehimisht shkeljen e ligjit, e lidhur kjo edhe me sa parashikon neni 432 i KPP, ku janë parashikuar shkaqet për të cilat lejohet rekursi. Konkretisht, neni 432 i KPP, në pikën 1 të tij, parashikon se rekursi kundër vendimit të gjykatës së apelit mund të bëhet kur nuk është respektuar ose është zbatuar gabim ligji material ose procedural i cili është me rëndësi për njësimin ose zhvillimin e praktikës gjyqësore; kur nuk është respektuar ose është zbatuar gabim ligji procedural me pasojë pavlefshmërinë e vendimit, pavlefshmërinë absolute të akteve ose papërdorshmërinë e provave; ose kur vendimi i ankimuar vjen në kundërshtim me praktikën e Kolegjit Penal ose të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

9- Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë vlerëson se, Gjykata e Apelit Durrës i ka dhënë përgjigje të argumentuar pretendimeve të personit nën hetim për shkelje të ligjit procedural penal, konkretisht neneve 228, 229, 230, 238, 251 dhe 252 të KPP, të paraqitura si shkaqe edhe në rekursin drejtuar Gjykatës së Lartë. Kolegji sjell në vëmendje se pjesa e pretendimeve në rekurs që ngre çështje të vlerësimit të provave del jashtë juridiksionit ekskluzivisht ligjor të Gjykatës së Lartë. Qëndrimi që mban Kolegji për rastin në shqyrtim, bazohet edhe në jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese dhe të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, sipas të cilave shkaqet e parashtruara në rekurs që rezultojnë haptazi të pabazuara vlerësohen si të papranueshme për pranimin e rekursit.

10- Në ballafaqim të shkaqeve të rekursit me dispozitat e ligjit procedural penal, Kolegji evidenton se ato janë të njëjta me shkaqet e apelit, shkaqe këto që janë trajtuar në mënyrë shteruese nga Gjykata e Apelit Durrës. Kolegji nuk konstatoi asnjë shkelje të dispozitave procedurale penale në lëndë të masave të sigurimit, përsa i përket kushteve dhe kriterëve të zbatimit të tyre në rastin konkret, përfshi këtu edhe nenin 230 të KPP, zbatimi i të cilës në rastin konkret është mirëargumentuar nga gjykatat e faktit. Nga ana tjetër, nuk rezulton të jetë i bazuar as pretendimi i parashtruar në rekurs se, qëndrimet e gjykatave janë në kundërshtim me Vendimin Unifikues të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lart me nr. 7 të vitit 2011.

11- Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, vlerëson se, rekursi i paraqitur në Gjykatën e Lartë kundër vendimit të Gjykatës së Apelit Durrës, nuk përmban ndonjë prej shkaqeve të sipërpërmendura dhe për rrjedhojë, nuk mund të pranohet.

PËR KËTO ARSYE

Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, bazuar në nenin 433 të Kodit të Procedurës Penale,

V E N D O S I

- Mospranimin e rekursit të paraqitur nga personi nën hetim Selim Çekaj kundër vendimit me nr. 10-2021-778(107), datë 22.04.2021, të Gjykatës së Apelit Durrës.

Tiranë, 01.06.2021

[shqiptarja.com]